



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

UDHËZUES

**Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”**

**1. FUSHA E ZBATIMIT DHE QËLLIMI PRAKTIKAVE NË BAZAT E TË DHËNAVE**

- (1) Qëllimi i këtij udhëzuesi është të jap udhëzime se kur dhe si mund të përdoren baza e të dhënave për të zbuluar, në mënyrë të kufizuar, sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale të përfituara gjatë procedurave të parashikuara në nenin 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”. Udhëzuesi synon të rrisë transparencën dhe parashikueshmërinë e procesit brenda kuadrit ekzistues ligjor dhe procedural, duke përmirësuar kështu efektivitetin e hetimeve për antitrustin dhe për përqendrimet.
- (2) Ky udhëzues nuk është shterues dhe bazohet në përvojën e fituar deri më tani dhe synon të pasqyrojnë praktikën aktuale. Disa çështjeje individuale me karakteristika specifike mund të kërkojnë përshtatjen ose devijimin nga ky dokument udhëzues. Praktikë më të mira për bazat e të dhënave nuk ndryshojnë të drejtat ose detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9121/2003 ose aktet nënligjore në fuqi.
- (3) Kuadri ligjor specifik dhe kufizimet në procedurat e parashikuara Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, duhen marrë parasysh se kur dhe si mund të përdoren baza e të dhënave për të zbuluar sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale të përfituara gjatë këtyre procedurave. Procedurat përqendrimeve karakterizohen në veçanti nga natyra e tyre tërësisht administrative, si dhe nga nevoja për procedura të përshpejtuara, duke pasur parasysh afatet kohore të shkurtra dhe ligjërish të detyrueshme brenda të cilave duhet të realizohen procedurat hetimore për përqendrimet.
- (4) Udhëzuesi “Mbi Konfidencialitetin dhe Aksesin në Dosje” jep udhëzime dhe trajton çështjet kryesore në lidhje me konfidencialitetin dhe aksesin në dosje, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të BE-së, duke sqaruar konceptet dhe procedurat që lidhen me këto çështje. Këto praktika më të mira për bazat e të dhënave plotësojnë praktikë më të mira për antitrustin dhe parashikojnë detaje të mëtejshme mbi rregullat e zbatueshme për procedurat për bazat e të dhënave.

## 2. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR BAZAT E TË DHËNAVE

- (5) Në kuadër të garantimit të të drejtës për tu mbrojtur, palët pas dërgimit të Raportit të Hetimit, kanë të drejtën e aksesit të versionit jo konfidencial të dosjes së AK, për të shqyrtuar pretendimet e ngritura kundër tyre, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Konkurrencës.
- (6) Në parim, aksesit në dosjen e AK jepet duke u dhënë palëve që janë njohur me Raportin e Hetimit, akses në një version elektronik të të gjithë dokumenteve që përmban dosja e AK, me përjashtim të dokumenteve të brendshme dhe informacionit konfidencial (psh, sekrete tregtare dhe informacioneve të tjera konfidenciale).
- (7) AK, gjatë procedurave hetimore merr informacione sasiore dhe cilësore, disa prej të cilave mund të shërbejnë si prova për të mbështetur hetimin. Të dhënat e mbledhura nga palë të treta (p.sh., të dhënat mbi kostot dhe çmimet, të dhënat e shitjeve, bidding data, marzhet etj.) shpeshherë përbëjnë sekrete tregtare, të cilat kanë natyrë konfidenciale. Në veçanti, nëse të dhënat kanë natyrë sasiore, mund të mos jetë e mundur që të ofrohet një version kuptimplotë jokonfidencial, në kohën e duhur. Në raste të veçanta, e njëjta gjë vlen edhe për informacionin cilësor (p.sh., dokumentet e brendshme të strategjisë të konkurrentëve). Megjithatë, dhënia e aksesit në këto të dhëna mund të jetë e nevojshme në rrethana të caktuara me qëllim që të garantohet mundësia e mbrojtjes.
- (8) Në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 9121/2003, AK ka detyrën për ruajtjen e informacionit konfidencial që mund të dëmtojë ndërmarrjen nëse zbulohet. Pavarësisht kësaj, në procedurat për antitrustin, në disa raste, një informacion konfidencial mund të zbulohet, por vetëm në rastet kur zbulimi i tij është i nevojshëm për të vërtetuar një shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, ose me qëllim që të garantohet mundësia e mbrojtjes. Për sa i përket procedurave të kontrollit të përqendrimeve, AK mund të marrë në konsideratë, në raste të veçanta, zbulimin e informacionit konfidencial të nevojshëm për qëllime të procedurës. Në rastet e përqendrimeve, duke pasur parasysh natyrën administrative të procedurës dhe nevojën për procedura të përshpejtuara, zakonisht AK e konsideron të nevojshme, në raste të veçanta, të zbulojë vetëm informacionet në të cilat është mbështetur hetimi. Në rastet e antitrust dhe përqendrimeve, informacioni konfidencial nuk do të zbulohet kur të drejtat e mbrojtjes së palëve mund të ushtrohen në bazë të versioneve jokonfidenciale të dokumenteve në dosjen e AK.
- (9) Bazat e të dhënave janë një instrument që, në varësi të rrethanave të çështjes individuale, mund të garantojë të drejtat për t'u mbrojtur duke respektuar njëkohësisht interesat legjitimë të konfidencialitetit të ndërmarrjeve apo personave nga të cilët AK ka marrë informacionin. Përmes bazës së të dhënave, palët që janë njohur me Raportin e Hetimit mund të aksesojë dokumentet në dosjen e AK, në mënyrë të kufizuar, pra duke limituar numrin dhe/ose kategorinë e personave që kanë akses dhe që e përdorin informacionin që po aksesohet deri

në masën që është absolutisht e nevojshme për të ushtruar të drejtat për t'u mbrojtur.

- (10) AK, sipas gjykimit të saj, vendos nëse një bazë të dhënash është e përshtatshme në një çështje të caktuar. AK vendos që të ofrojë një bazë të dhënash, me iniciativën e saj ose me kërkesë të palëve që janë njohur me Raportin e Hetimit, kur e gjykon të nevojshme dhe proporcionale diçka të tillë bazuar në parimet e përcaktuara më sipër dhe me kusht që çdo vështirësi ligjore dhe praktike të mund të zgjidhet me shpejtësi dhe me dakordësinë e palëve të përfshira drejtpërdrejtë në procedura dhe palët të cilët kanë depozituar të dhëna.
- (11) Kur merret vendimin nëse një çështje e caktuar është e përshtatshme për procedurën për bazat e të dhënave, AK do të marrë gjithashtu në konsideratë nëse është e përshtatshme që të japë akses në atë moment të caktuar, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, natyrën dhe shkallën e sensitivitetit të informacionit, ecurinë e çështjes, burimet e lidhura me funksionimin e bazave të të dhënave, riskun e rrjedhjes së informacionit dhe nevojën për procedura të përshtetshme. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme në procedurat e parashikuara në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, në të cilat AK është subjekt i afateve kohore të shkurtra dhe ligjërisht të detyrueshme brenda të cilave duhet të kryhen procedurat e kontrollit të përqendrimeve.
- (12) Aksesin në një bazë të dhënash është subjekt i respektimit të rregullave për bazën e të dhënave, rregullat për konfidencialitetin e ndërmarrjeve dhe sanksionet në rastin e mosrespektimit të rregullave. (shihni **Shtojcën A** për rregullat standarde për bazat e të dhënave (“Rregullat për bazat e të dhënave”) dhe **Shtojcën B** për marrëveshjen standarde për ruajtjen e fshehtësisë (“Marrëveshja për ruajtjen e fshehtësisë”).

### **3. QELLIMI I TË DHËNAVE TË PËRFSHIRA NË BAZËN E TË DHËNAVE**

- (13) AK organizon bazën e të dhënash në një sërë rastesh, kryesisht për zbulimin e të dhënave sasiore (p.sh., të dhënat për shitjet individuale, të dhënat mbi çmimin, të dhënat për kostot, të dhënat e ofertimit, marzhet etj.), në të cilat AK është mbështetur gjatë hetimit. Në disa raste të veçanta, bazat e të dhënave organizohen edhe për zbulimin e të dhënave cilësore (p.sh., dokumentet e brendshme të strategjisë). Të njëjtat parime bazë për sa i përket qëllimit dhe fushëveprimit zbatohen për bazat e të dhënave sasiore dhe cilësore.
- (14) Shpeshherë, të dhënat sasiore janë konfidenciale pasi përfshijnë zakonisht informacione strategjike të brendshme dhe sensitive. Krahas shqetësimeve të lidhura me konfidencialitetin, shkëmbimi i të dhënave strategjike ndërmjet konkurrentëve mund të çojë në ulje të konkurrencës, për shembull, duke lehtësuar praktikën e bashërenduara, duke dëmtuar konsumatorët ose në mënyra të tjera. Për më tepër, shpeshherë është e pamundur apo tejet e vështirë që ofruesi i të dhënave të sigurojë versione kuptimplota jokonfidenciale në kohën e duhur, për shkak të

vëllimit të të dhënave dhe/ose vështirësisë së përgatitjes së një versioni jokonfidencial me vlerë mjaftueshëm provuese.

- (15) Të dhënat sasiore të përfshira në një bazë të dhënash duhet t'u mundësojnë palëve të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit që, përmes këshilltarëve të tyre të jashtëm, të verifikojnë metodologjinë e përdorur nga AK për mbledhjen, verifikimin e konsistencës, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave të përdorura në hetim, si dhe që të përsërisin dhe verifikojnë qëndrueshmërinë e analizës së AK. Për rrjedhojë, kodet softuerike, të cilat mund të jenë të nevojshme për të ushtruar në të drejtat për t'u mbrojtur, veçanërisht për sa kohë që janë përdorur nga AK për qëllimin e analizës së paraqitur në Raportin e Hetimit, mund të përfshihen në një bazë të dhënash pas shqyrtimit nga AK.
- (16) Siç përcaktohet në paragrafin 13, në raste të veçanta, dokumentet cilësore konfidenciale mund të zbulohen për këshilltarët e jashtëm e palëve të cilët janë njohur me Raportin e Hetimit, përmes procedurës për bazat e të dhënave. Një bazë e të dhënave cilësore mund të organizohet kur nuk është e mundur ose është shumë e vështirë që palët të cilët kanë depozituar të dhëna të sigurojë versione kuptimplota jokonfidenciale të këtyre dokumenteve cilësore (për shembull, dokumentet e brendshme të strategjisë), në kohën e duhur dhe me vlerë provuese të mjaftueshme. Organizimi i një baze të dhënash në këto rrethana u jep mundësinë palëve që, përmes këshilltarëve të tyre të jashtëm, të verifikojnë provat në dosjen e AK, në rastet kur zbulimi i këtyre informacioneve konfidenciale mund të jetë i nevojshëm për të ushtruar të drejtën për t'u mbrojtur, veçanërisht për sa kohë që është mbështetur mbi këto informacione konfidenciale.
- (17) Në varësi të rrethanave specifike të çështjes, AK mund të kufizojë plotësisht disa të dhëna të caktuara të përfshira në bazën e të dhënave, për shembull, duke i përkthyer të gjitha dokumentet në të njëjtën gjuhë,<sup>1</sup> duke hequr numrat e identifikimit (ID) të dokumenteve, duke ndryshuar valutën e vlerave ekonomike, duke redaktuar vendet dhe territoret, duke kufizuar pjesërisht shifrat ose duke marrë çdo masë tjetër që gjykohet e nevojshme për të mbrojtur identitetin dhe konfidencialitetin e ofruesve të të dhënave dhe për të minimizuar riskun e kundërpërgjigjeve të mundshme.

#### **4. ORGANIZIMI I BAZAVE TË TË DHËNAVE**

##### **4.1. Koha e organizimit të një baze të dhënash**

- (18) Një bazë të dhënash mund të organizohet në çdo kohë kur mund të jepet akses në dosjen e AK (pra, pasi palëve ju është dërguar Raporti i Hetimit dhe kanë mundësinë për t'u dëgjuar para së të merret një vendim). Baza e të dhënave organizohet përpara seancës dëgjimore.

---

<sup>1</sup> AK nuk ka asnjë detyrim që të sigurojë një përkthim të dokumenteve në dosje

## 4.2. Pjesëmarrësit në bazën e të dhënave

- (19) Për shkak të sensitivitetit dhe natyrës konfidenciale të të dhënave që përmban baza e të dhënave, aksesit në bazën e të dhënave është i kufizuar në një grup personash, më konkretisht “vetëm për këshilltarët e jashtëm”.
- (20) Në parim, këshilltarët e jashtëm përfshijnë vetëm këshilltarët e jashtëm ekonomikë dhe/ose konsulentët e jashtëm ligjorë të palëve të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit, në varësi të natyrës sasiore ose cilësore të bazës së të dhënave. Aksesit në bazën e të dhënave u jepet vetëm një numri të paracaktuar të këshilltarëve të jashtëm, në veçanti për të verifikuar vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e analizave sasiore të AK, të përdorura në dosjen e hetimit, ose për të vlerësuar nëse provat cilësore të dosjes së AK mbështesin përfundimet e nxjerra dhe kundërshtimet e ngritura prej tij. Aksesit në një bazë të dhënash jepet vetëm me qëllimin që t’u mundësojë këshilltarëve të jashtëm të këshillojnë klientët e tyre, pra palëve të cilët janë njohur me pretendimet kundër tyre, lidhur me ushtrimin e të drejtave të tyre për t’u mbrojtur, pa u treguar klientëve të tyre informacionin konfidencial që patën mundësinë të shihnin.

## 4.3. Rregullat për bazat e të dhënave

- (21) Çdo bazë e të dhënave, e organizuar nga AK, u nënshtrohet rregullave për bazat e të dhënave, të cilat duhet të pranohen nga palët tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit dhe të nënshkruhen nga këshilltarët e jashtëm përpara marrjes së aksesit në bazën e të dhënave.
- (22) Rregullat për bazat e të dhënave parashikojnë se aksesit në bazën e të dhënave jepet në përputhje me detyrimet e konfidencialitetit, nën masa të përmirësuara të sigurisë dhe nën mbikëqyrje të përshtatshme. Rregullat standarde për bazat e të dhënave jepen në **Shtojcën A**.
- (23) Këshilltarët e jashtëm nuk heqin të dhëna, informacione apo dokumente nga baza e të dhënave dhe nuk u japin palëve tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit ose palëve të treta, informacione konfidenciale të përfutuara në kuadër të procedurës për bazat e të dhënave. Pikë së pari, këshilltarët e jashtëm duhet të garantojnë se respektojnë rregullat përkatëse të sjelljes profesionale dhe se janë në gjendje të veprojnë mbi bazën e këtyre rregullave. Gjithashtu, ata duhet të garantojnë se, kur është e nevojshme, klientët e tyre do të heqin dorë nga të drejtat e lidhura me këto rregulla.
- (24) Po kështu, një palë tek i cili është dërguar Raporti i Hetimit nuk duhet të kërkojë dhe as të marrë kurrë informacione konfidenciale nga baza e të dhënave përmes këshilltarëve të tij të jashtëm. Këshilltarët e jashtëm mund t’i japin palëve vetëm një raport jokonfidencial të bazës së të dhënave.
- (25) AK u vë në dispozicion këshilltarëve të jashtëm, pajisjet përkatëse teknike për t’u mundësuar atyre që të përgatisin raportin e bazës së të dhënave. Këshilltarët e jashtëm do të kenë në dispozicion të tyre një numër të paracaktuar stacionesh

pune të sigurta dhe të pajisura me kompjuter, të cilat menaxhohen nga AK dhe janë të pajisura me softuerin e nevojshëm dhe grupet përkatëse të të dhënave, sipas rastit. Çdo ditë, bëhet një kopje rezervë e të dhënave në këto stacione për të garantuar vijimësinë e punës. Për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet këshilltarëve të jashtëm në bazën e të dhënave, AK krijon një hapësirë të përbashkët bashkëpunimi në stacionet e punës të pajisura me kompjuter. Baza e të dhënave është e hapur gjatë ditëve dhe orareve të punës të dakordësuara nga AK (duke marrë në konsideratë nevojën për procedura të përsheptuara), të cilat përcaktohen shprehimisht në Rregullat për bazat e të dhënave.

- (26) Këshilltarët e jashtëm mund të sjellin kode kompjuterike, materiale të printuara ose tekste shtesë në format elektronik në bazën e të dhënave (p.sh., shënime të shkruara me dorë, të printuara, ose skedarë teksti elektronikë, një kopje të pretendimeve të ngritura etj.), të cilat mund të jenë të nevojshme për të verifikuar analizën e AK dhe për të përgatitur raportin e bazës së të dhënave. Materialet e printuara që sillen në bazën e të dhënave nga këshilltarët e jashtëm mund të shqyrtohen në çdo kohë nga punonjësit e AK. Këto dokumente nuk mund të nxirren nga baza e të dhënave, në asnjë rrethanë, si dhe shkatërrohen në fund të procedurës për bazat e të dhënave.
- (27) Gjatë procedurës për bazat e të dhënave, këshilltarët e jashtëm mund (i) të marrin shënime, të kopjojnë ose replikojnë të dhënat, si dhe (ii) të printojnë dokumentet, në faqet boshe me numra të përcaktuar paraprakisht, të ofruara nga AK. Të gjitha materialet e printuara dhe shënimet mund të shqyrtohen në çdo kohë nga punonjësit e AK. Këto materiale të printuara dhe shënime nuk mund të nxirren nga baza e të dhënave, në asnjë rrethanë, si dhe shkatërrohen në fund të procedurës për bazat e të dhënave.
- (28) Nuk lejohet asnjë komunikim i jashtëm, në asnjë lloj forme. Baza e të dhënave do të monitorohet gjatë të gjithë kohës. Këshilltarët e jashtëm nuk mund të mbajnë asnjë pajisje elektronike, kamera, telefon celular ose pajisje të tjera komunikimi apo regjistrimi gjatë kohës që janë në bazën e të dhënave.
- (29) Për më tepër, rregullat për bazat e të dhënave përcaktojnë:
- objektin e të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave dhe çdo kufizim të mundshëm lidhur me përdorimin e tyre,
  - pajisjet që do të vihen në dispozicion,
  - kohëzgjatjen dhe oraret e punës së bazës së të dhënave,
  - ambientet ku do të organizohet baza e të dhënave,
  - kushtet në bazë të të cilave do të jepet akses në bazën e të dhënave,
  - sanksionet për mosrespektimin e rregullave për bazat e të dhënave, si dhe
  - çdo kusht tjetër të cilit do t'i nënshtrohet baza e të dhënave në rastin individual.
- (30) Përpara marrjes së aksesit në bazën e të dhënave, këshilltarët e jashtëm duhet të nënshkruajnë gjithashtu Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë. Marrëveshja për

ruajtjen e fshehtësisë përcakton detyrimet dhe përgjegjësitë e personave që aksesojnë bazën e të dhënave. Në veçanti, duke nënshkruar Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë, këshilltarët e jashtëm angazhohen, ndër të tjera, që t'i përdorin të dhënat konfidenciale vetëm për të verifikuar analizën e hetimit të AK, siç përshkruhet në paragrafët 15 dhe 16, si dhe për të hartuar një raport jokonfidencial.

#### **4.4. Raporti i bazës së të dhënave**

- (31) Pas marrjes së aksesit në bazën e të dhënave dhe vetëm gjatë kohës së aksesit në bazën e të dhënave, këshilltarët e jashtëm mund të përgatisin një raport të bazës së të dhënave (“Raporti i bazës së të dhënave”). Raporti i bazës së të dhënave është instrumenti i vetëm përmes të cilit këshilltarët e jashtëm mund të komunikojnë dhe diskutojnë të dhënat në bazën e të dhënave me palët tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit, të cilët nuk mund të kenë akses në këto të dhëna në një mënyrë tjetër.<sup>2</sup>
- (32) Raporti i bazës së të dhënave përmban gjetjet dhe konkluzionet e këshilltarëve të jashtëm lidhur me vlerësimin e të dhënave përkatëse që kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtave të klientëve të tyre për t'u mbrojtur, siç përshkruhet në paragrafët 15 dhe 16. Si rregull i përgjithshëm, analiza e të dhënave sasiore që realizohet nga këshilltarët e jashtëm duhet të jetë e replikueshme nga AK.<sup>3</sup> Në veçanti, çdo analizë që qëndron në themel të gjetjeve apo konkluzioneve në raportin e bazës së të dhënave duhet të dokumentohet dhe identifikohet nga këshilltarët e jashtëm.
- (33) Raporti i bazës së të dhënave duhet të përmbajë vetëm informacion jokonfidencial. Në fund të procedurës për bazat e të dhënave, AK duhet të shqyrtojë dhe miratojë raportin e bazës së të dhënave që është përgatitur dhe finalizuar nga këshilltarët e jashtëm, për të garantuar se raporti nuk përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.<sup>4</sup> Vetëm pas miratimit të tij, AK do t'i dërgojë çdo palë që i është dërguar Raporti i Hetimit, raportin individual të bazës së të dhënave të përgatitur nga këshilltarët e tyre përkatës të jashtëm.
- (34) Këshilltarët e jashtëm nuk heqin asnjë të dhënë, informacion apo dokument nga baza e të dhënave, edhe nëse këto të dhëna, informacione apo dokumente nuk përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.
- (35) Nuk mund të pretendohet një privilegj profesional juridik ose ndonjë lloj tjetër mbrojtjeje e privilegjuar kundrejt një pjese të raportit të bazës së të dhënave që do t'u jepet palëve tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit.

---

<sup>2</sup> Për të shmangur dyshimet, kur aksesi në bazën e të dhënave u jepet këshilltarëve të jashtëm që veprojnë për disa palë që ju është dërguar Raporti i Hetimi, atëherë vetëm një raport i bazës së të dhënave mund të përgatitet për çdo palë nga këshilltarët e tyre përkatës të jashtëm, gjatë kohës së aksesit në bazën e të dhënave.

<sup>3</sup> Këshilltarët e jashtëm janë përgjegjës për të garantuar aspektin e replikueshmërisë.

<sup>4</sup> Gjatë shqyrtimit të raportit të bazës së të dhënave, AK mund të bëjë redaktime të mëtejshme për të mbrojtur sekretet tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale të palëve të treta, përpara se të miratojë raportin e bazës së të dhënave.

- (36) Gjatë aksesit në bazën e të dhënave, këshilltarët e jashtëm mund të vendosin që të përgatisin, si dhe të vënë në dispozicion të AK, një version të paredaktuar dhe konfidencial të raportit të bazës së të dhënave, me qëllimin e vetëm që të shpjegojnë më në detaje se si i kanë kryer llogaritjet e tyre dhe si kanë arritur në gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në raportin e bazës së të dhënave. Në këtë rast, këshilltarët e jashtëm shpjegojnë dallimet ndërmjet të dy versioneve të raportit të bazës së të dhënave, duke nënvizuar rezultatet apo çdo informacion konfidencial në versionin e paredaktuar dhe konfidencial të raportit të bazës së të dhënave. Versioni i paredaktuar dhe konfidencial i raportit të bazës së të dhënave do të regjistrohet në dosjen e AK, do të zotërohet vetëm nga AK dhe nuk do t'i vihet në dispozicion palëve të që janë njohur me Raportin e Hetimit.

#### **4.5. Sanksionet për mosrespektimin e rregullave për bazat e të dhënave**

- (37) Duke nënshkruar Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë dhe duke rënë dakord me rregullat për bazat e të dhënave, këshilltarët e jashtëm pranojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre që rezultojnë nga procedura për bazat e të dhënave. Nëse një nga këshilltarët e jashtëm nuk respekton rregullat dhe detyrimet, të gjithë këshilltarëve të jashtëm të palës përkatëse do u kërkohet që të largohen menjëherë nga baza e të dhënave.
- (38) Për më tepër, AK dhe ofruesit e të dhënave mund të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore në rastin e shkeljes së rregullave për bazat e të dhënave dhe/ose të Marrëveshjes për ruajtjen e fshehtësisë, duke përfshirë, ndër të tjera, veprimet për dëmet. AK informon institucionet përkatëse, sipas rastit, rreth shkeljes së rregullave së etikës apo të sjelljes profesionale.

### **5. PËRFSHIRJA PALËVE TË CILËT KANË DEPOZITUAR TË DHËNA NË NJË PROCEDURË PËR BAZAT E TË DHËNAVE**

- (39) Pas marrjes së një kërkesë nga palët të cilët janë informuar në lidhje me gjetjet, për organizimin e një baze të dhënash, AK do të informojë me shkrim palët të cilët kanë depozituar të dhëna dhe do të kërkojë të marrë miratimin e tyre. AK do të identifikojë informacionin që do të zbulohet dhe do të japë arsyet për këtë propozim. AK do të vendosë një periudhë kohore gjatë të cilës palët të cilët kanë depozituar të dhëna mund të dorëzojnë komente me shkrim.
- (40) Palët të cilët kanë depozituar të dhëna pranë AK, do të jenë në gjendje të shprehin çdo shqetësim të mundshëm lidhur me procedurën për bazat e të dhënave, për shembull, shqetësimet rreth kundërpërgjigjeve të mundshme nga palët të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit, do të kenë mundësi të shqyrtojnë rregullat për bazat e të dhënave dhe Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë dhe të japin komente, si dhe të rishikojnë listën e këshilltarëve të jashtëm me qëllim identifikimin e konflikteve të mundshme të interesit.
- (41) AK mund të zbatojë masa për të trajtuar këto shqetësime. Për shembull, nëse ofruesit e të dhënave janë të shqetësuar rreth kundërpërgjigjeve të mundshme nga



palët të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit, atëherë AK mund të kufizojë plotësisht ose pjesërisht disa të dhëna deri në masën që është e nevojshme për ti mundësuar palëve që të ushtrojnë të drejtat e tyre për t'u mbrojtur.

- (42) AK synon të pajtohet me interesat e kundërta të palëve të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit, dhe ndaj palët të cilët kanë depozituar të dhëna, në mirëbesim, duke përshpejtuar procedurat në masën e mundshme.
- (43) Në çdo moment gjatë ekzistencës së bazës së të dhënave, konsulenti ligjor i ofruesve të të dhënave, me kërkesë të tyre, mund të lejohet të aksesojë bazën e të dhënave me qëllimin e vetëm për të garantuar ekzistencën e masave mbrojtëse të përshtatshme.

## **6. SEANCA DËGJIMORE**

- (44) Në rastin e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme ndërmjet AK dhe palëve të cilët ju është dërguar Raporti i Hetimit, ose palëve të cilët kanë depozituar të dhëna, në lidhje me zbulimin e informacionit konfidencial, përmes bazës së të dhënave, çështja mund të ngrihet përpara Komisionit të Konkurrencës. Palët të cilëve ju është dërguar Raporti i Hetimit nëse gjykojnë se nevojitet akses i mëtijshëm për të ushtruar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar, mund ta ngrenë çështjen gjatë seancës dëgjimore. E njëjta gjë vlen edhe për palët të cilët kanë depozituar të dhëna, në rastet kur kundërshtojnë zbulimin e informacionin që e konsiderojnë konfidencial.
- (45) Komisioni e bazon vendimin vetëm në pretendime, për të cilat palëve u është dhënë mundësia për t'u shprehur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

**Shtojca A: Rregullat standarde për bazat e të dhënave**

**KUSHTET PËR ZBULIMIN E SEKRETEVE TREGTARE DHE TË  
INFORMACIONEVE TË TJERA KONFIDENCIALE VETËM “PËR KËSHILLTARËT  
E JASHTËM”  
("RREGULLAT PËR BAZAT E TË DHËNAVE")**

Çështja [\_\_\_\_\_]

Në kuadër të aksesit në dosjen e AK që i jepet [*Emri i Palës/Palëve të cilave u jepet akses në bazën e të dhënave nëpërmjet këshilltarëve të tyre të jashtëm*] në çështjen [\_\_\_\_\_] - në zbatim të nenit 39 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pikës 24 të sipas Udhëzuesit “Mbi Konfidencialitetin dhe Aksesin në Dosje” dhe nenit 17 dhe 19 të Rregullores për Procedurat Hetimore), AK vë në dispozicion një hapësirë në ambientet e saj në Rrugën “Sami Frashëri”, nr. 4, Kati IV, Tiranë (“Baza e të dhënave”) për [*këshilltarët e jashtëm ekonomikë dhe/ose konsulentët e jashtëm ligjorë*] (“Këshilltarët e jashtëm”) të udhëzuar nga [*Emri i Palës/Palëve të cilave u jepet akses në bazën e të dhënave nëpërmjet Këshilltarëve të tyre të jashtëm*] (“[Pala/Palët]”) për hetimin në çështjen [\_\_\_\_\_]. [*Pala/Palët*], [*kërkuan/pranuan*] procedurën për bazën e të dhënave me email më datë [*Data e emailit*].

Baza e të dhënave përmban informacione të cilat AK i konsideron se përbëjnë sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale sipas Udhëzuesit “Mbi Konfidencialitetin dhe Aksesin në Dosje, dhe për rrjedhojë, në raste të veçanta, ato do të vihen në dispozicion në kuadër të procedurës për bazat e të dhënave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregullat për bazat e të dhënave.

Siç përcaktohet në Praktikat më të mira për bazat e të dhënave, AK, në raste të veçanta, duke garantuar të drejtën e palëve për t’u mbrojtur me interesat legjitimë të konfidencialitetit të ofruesëve të të dhënave, mund të zbulojë informacione specifike me qëllimin e vetëm për t’u dhënë këshilltarëve të jashtëm një mundësi për të kuptuar më mirë provat e AK në lidhje me [*Shpjegimi i të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave*] në mënyrë që të mund t’i përgjigjen pretendimeve të ngritura kundër tyre në emër të [*Emri i Palës*]. Zbulimi i mëtejshëm i të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave pa miratimin paraprak me shkrim të AK është rreptësisht i ndaluar.

Mbetet në diskrecionin absolut të AK, për ngritjen e bazës së të dhënave, si një instrument për dhënien e aksesit në dosje, në rrethana shumë të kufizuara ku nuk është e mundur ose është shumë e vështirë që palët të cilët kanë depozituar informacion të sigurojë versione kuptimplota jokonfidenciale të një pjese të dosjes së AK me vlerë provuese të mjaftueshme dhe në kohën e duhur.<sup>1</sup> Sekretet tregtare dhe informacionet e tjera konfidenciale që nuk janë të nevojshme për ushtrimin e të drejtave për t’u mbrojtur ose vlera provuese e të cilave mund të zbulohet në një mënyrë tjetër, lihen jashtë objektit të të dhënave të përfshira në një bazë të dhënash për të shmangur

<sup>1</sup> Duke marrë në konsideratë nevojën për një zbatim efikas të rregullave të konkurrencës brenda kuadrit ekzistues ligjor për antitrustin dhe për përqendrimet, në veçanti nevojën për procedura të përshpejtuara në rastin e procedurave për përqendrimet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

ekspozimin e panevojshëm të informacionit konfidencial të ofruesit të të dhënave.

Rregullat për bazat e të dhënave zbatohen për këshilltarët e jashtëm dhe krijohen për të garantuar mbrojtjen legjitime të sekreteve tregtare dhe informacioneve të tjera konfidenciale të [Ofruesit të të dhënave] të mbledhura nga AK në kuadër të hetimit të tij të vazhdueshëm në çështjen e përmendur më sipër.

Këshilltarët e jashtëm dhe çdo person që bën pjesë në ekipin e këshilltarëve të jashtëm duhet të bien dakord me rregullat për bazat e të dhënave dhe të nënshkruajnë marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë të bashkëngjitur, përpara se të marrin akses në bazën e të dhënave dhe në vetë të dhënat. Këshilltarët e jashtëm dhe çdo person që bën pjesë në ekipin e këshilltarëve të jashtëm angazhohen të respektojnë të gjitha kushtet e mëposhtme.

Përpara se të mund të aksesojnë të dhënat, këshilltarët e jashtëm do të vënë në dispozicion të grupit të ngarkuar me çështjen (*kontakt: personi i kontaktit, tel: +xxxxx*) emrin, numrin e një dokumenti të vlefshëm identiteti (pasaportë ose kartë identiteti), pozicionin e punës dhe punëdhënësin e çdo anëtari të ekipit të këshilltarëve të jashtëm që do të aksesojë bazën e të dhënave. Këshilltarët e jashtëm nuk do të jenë më shumë se [numri i personave] persona. Identiteti i këshilltarëve të jashtëm do t'i zbulohet ofruesve të të dhënave përpara se t'u jepet akses në bazën e të dhënave.

Vetëm këta persona do të lejohen të aksesojnë bazën e të dhënave. Karta e identifikimit të vizitorit do të duhet të mbahet në një vend të dukshëm gjatë gjithë kohës. Për të përshpejtuar procedurat e aksesit, Palët do të duhet të informojnë paraprakisht dhe me shkrim grupin e AK të cilët janë të ngarkuar të merren me çështjen (mundësisht me email) për përbërjen e ekipit të këshilltarëve të jashtëm që do të jenë të pranishëm në një datë të caktuar.

Hyrja në bazën e të dhënave, sjellja brenda saj dhe përdorimi i të dhënave janë subjekt i këtyre rregullave:

## 1. PAJISJET

- (1) Në bazën e të dhënave do të ketë në dispozicion [numër] kompjuter[ë] me specifikimet e mëposhtme teknike:
  - (a) [Softuer i përpunimit të tekstit (me një modifikues ekuacionesh) / Softuer i përpunimit të excelit / Softuer i leximit të PDF-ve].
  - (b) [Softuer statistikor dhe i analizimit të të dhënave ].
- (2) [Ky/Këta] kompjuter[ë] [vihet/vihen] në dispozicion me qëllimin për t'u dhënë këshilltarëve të jashtëm një mundësi për të [verifikuar provat në dosjen e AK, në rastet kur zbulimi i këtyre informacioneve konfidenciale mund të jetë i nevojshëm për të ushtruar të drejtat për t'u mbrojtur, veçanërisht për sa kohë që hetimi është mbështetur mbi këto informacione konfidenciale/për të verifikuar metodologjinë e përdorur nga AK për mbledhjen, verifikimin e konsistencës, menaxhimin dhe analizimin e të dhënave të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

*përdorura në hetim]* dhe për të hartuar Raportin për Palët (shihni seksionin 3 të Rregullave për bazën e të dhënave).

- (3) Këshilltarëve të jashtëm nuk do t'u vihet në dispozicion asnjë pajisje e jashtme ruajtje.
- (4) Në dispozicion do të vihet edhe një printer lokal me faqe boshe të numëruara [*dhe një rrjet lokal që lidh stacionet e punës të pajisura me kompjuter me printerin*].

## 2. KUSHTET E AKSESIMIT TË TË DHËNAVE

- (5) Të dhënat do të vihen në dispozicion të këshilltarëve të jashtëm në formë elektronike. Kompjuteri[*ët*] do të kenë akses në një dosje të veçantë në të cilën do të ketë disa skedarë vetëm për lexim për t'u shqyrtuar nga këshilltarët e jashtëm. Çdo ditë, bëhet një kopje rezervë e të dhënave në këto stacione për të garantuar vijimësinë e punës. Për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet këshilltarëve të jashtëm në bazën e të dhënave, AK krijon një hapësirë të përbashkët bashkëpunimi në stacionet e punës të pajisura me kompjuter.
- (6) Këshilltarët e jashtëm mund të sjellin kode kompjuterike, materiale të printuara ose tekste shtesë në format elektronik në bazën e të dhënave (p.sh., shënime të shkruara me dorë, të printuara, ose skedarë teksti elektronikë, një kopje të Raportit etj.), të cilat mund të jenë të nevojshme për të verifikuar analizën e AK dhe për të përgatitur raportin e bazës së të dhënave. Materialet e printuara që sillen në bazën e të dhënave nga këshilltarët e jashtëm mund të shqyrtohen nga punonjësit AK në çdo kohë. Këto dokumente nuk mund të nxirren nga baza e të dhënave, në asnjë rrethanë, si dhe shkatërrohen në fund të procedurës për bazat e të dhënave.
- (7) Gjatë procedurës për bazat e të dhënave, këshilltarët e jashtëm mund (i) të marrin shënime, të kopjojnë ose replikojnë të dhënat, si dhe (ii) të printojnë dokumentet, në faqet boshe me numra të përcaktuar paraprakisht, të ofruara nga AK. Të gjitha materialet e printuara dhe shënimet mund të shqyrtohen në çdo kohë nga punonjësit e AK. Këto materiale të printuara dhe shënime nuk mund të nxirren nga baza e të dhënave, në asnjë rrethanë, si dhe shkatërrohen në fund të procedurës për bazat e të dhënave.
- (8) Këshilltarët e jashtëm në çdo rast nuk duhet të pengojnë funksionimin e regjistrimit të softuerit që u është vënë në dispozicion në bazën e të dhënave. Një evidencë e gjeneruar automatikisht dhe veprimet përkatëse të kryera në bazën e të dhënave do të mbahet në njësinë e diskut të kompjuterit ku janë kryer këto manipulime dhe veprime përkatëse. Gjithashtu, çdo skedar i krijuar/modifikuar dhe veprime përkatëse të kryera në bazën e të dhënave do të mbahet në njësinë e diskut të kompjuterit ku janë kryer këto manipulime dhe veprime përkatëse.
- (9) Nuk lejohet asnjë komunikim i jashtëm, në asnjë lloj forme. Këshilltarëve të jashtëm nuk u lejohet të mbajnë asnjë pajisje elektronike, kamera, telefon celular ose pajisje të tjera komunikimi apo regjistrimi gjatë kohës që janë në bazën e të dhënave. Këshilltarët e jashtëm bien dakord që të kontrollohen në çdo kohë ndërmjet çdo hyrjeje dhe daljeje nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

baza e të dhënave. Çdo pajisje, si telefonat celularë apo pajisje të tjera celulare me valë, laptopë, PDA, regjistruer zëri, kamera, CD, DVD, USB dhe të ngjashme, do të kyçen dhe do të kthehen pas daljes nga baza e të dhënave (ose në fund të ditës).

- (10) Baza e të dhënave do të monitorohet gjatë gjithë kohës. Kushdo që lë bazën e të dhënave, gjatë qëndrimit në ambientet e AK do të shoqërohet nga stafi i Autoritetit.

### 3. RAPORTIMI PRANË [PALËS/PALËVE] OSE KOMISIONIT

- (11) Këshilltarët e jashtëm mund të komunikojnë dhe diskutojnë me palët të cilëve ju është dërguar Raporti Hetimit ([Pala/Palët]) mbi të dhënat në bazën e të dhënave vetëm përmes një raporti jokonfidencial (“Raporti i bazës së të dhënave”).<sup>2</sup>
- (12) Raporti i bazës së të dhënave përmban gjetjet dhe konkluzionet e këshilltarëve të jashtëm lidhur me vlerësimin e të dhënave të konsultuara, që kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtave për t’u mbrojtur të klientëve të tyre, siç përshkruhet në paragrafin 2.
- (13) Raporti i bazës së të dhënave duhet të përmbajë vetëm informacion jokonfidencial. Në fund të procedurës për bazat e të dhënave, AK duhet të shqyrtojë dhe miratojë raportin e bazës së të dhënave që është përgatitur dhe finalizuar nga këshilltarët e jashtëm, për të garantuar se raporti nuk përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.<sup>3</sup> Vetëm pas miratimit të tij, AK do t’i dërgojë çdo pale raportin individual të bazës së të dhënave të përgatitur nga këshilltarët e tyre përkatës të jashtëm.
- (14) Këshilltarët e jashtëm nuk heqin asnjë të dhënë, informacion apo dokument nga baza e të dhënave, edhe nëse këto të dhëna, informacione apo dokumente nuk përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.
- (15) Nuk mund të pretendohet një privilegj profesional juridik ose ndonjë lloj tjetër mbrojtjeje e privilegjuar kundrejt një pjese të raportit të bazës së të dhënave që do t’u jepet palëve.
- (16) Gjatë aksesit në bazën e të dhënave, këshilltarët e jashtëm mund të vendosin që të përgatisin, si dhe të vënë në dispozicion të AK, një version të paredaktuar dhe konfidencial të raportit të bazës së të dhënave, me qëllimin e vetëm që të shpjegojnë më në detaje se si i kanë kryer llogaritjet e tyre dhe si kanë arritur në gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura në raportin e bazës së të dhënave. Në këtë rast, këshilltarët e jashtëm shpjegojnë dallimet ndërmjet të dy versioneve të raportit të bazës së të dhënave, duke nënvizuar rezultatet apo çdo informacion konfidencial në versionin e paredaktuar dhe konfidencial të raportit të bazës së të dhënave të përfshirë në versionin e paredaktuar dhe konfidencial të raportit të bazës së të dhënave. Versioni i paredaktuar dhe konfidencial i raportit të bazës së të

<sup>2</sup> Për të shmangur dyshimet, kur aksesit në bazën e të dhënave u jepet këshilltarëve të jashtëm që veprojnë për disa palë që ju është dërguar Raporti i Hetimit, atëherë vetëm një raport i bazës së të dhënave mund të përgatitet për çdo palë nga këshilltarët e tyre përkatës të jashtëm, gjatë kohës së aksesit në bazën e të dhënave.

<sup>3</sup> Gjatë shqyrtimit të raportit të bazës së të dhënave, AK mund të bëjë redaktime të mëtejshme për të mbrojtur sekretet tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale të palëve të treta, përpara se të miratojë raportin e bazës së të dhënave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

dhënave do të regjistrohet në dosjen e AK, do të zotërohet vetëm nga AK dhe nuk do t'i vihet në dispozicion palëve.

**4. KOHËZGJATJA E AKSESIT NË BAZËN E TË DHËNAVE**

- (17) Baza e të dhënave do të jetë e hapur për një periudhë fillestare prej [XX] ditësh pune[] nga ora 8:00 deri në orën 16:30.

**5. PRANIA E MUNDSHME E KONSULENTIT LIGJOR TË [OFRUESIT TË TË DHËNAVE]**

- (18) Në çdo moment gjatë procedurës për bazën e të dhënave, konsulenti ligjor i [*Ofruesit(ëve) të të dhënave*], me kërkesë të tyre, mund të lejohet të aksesojë bazën e të dhënave me qëllimin e vetëm për të verifikuar ekzistencën e masave mbrojtëse të përshtatshme.

**6. SANKSIONET**

- (19) Duke nënshkruar Marrëveshjen për ruajtjen e fshehtësisë dhe duke rënë dakord me rregullat për bazat e të dhënave, këshilltarët e jashtëm të palëve që bëjnë njoftimin pranojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre që rezultojnë nga procedura për bazat e të dhënave. Në rast se një nga këshilltarët e jashtëm të palëve që bëjnë njoftimin nuk respekton rregullat dhe detyrimet, të gjithë pjesëmarrësve në bazën e të dhënave të palës përkatëse do u kërkohej që të largohen menjëherë nga baza e të dhënave.
- (20) Për më tepër, AK dhe palët të cilët kanë depozituar informacion marrin të gjitha veprimet e përshtatshme ligjore në rastin e shkeljes së rregullave për bazat e të dhënave dhe/ose të Marrëveshjes për ruajtjen e fshehtësisë, duke përfshirë, ndër të tjera, veprimet për dëmet. AK informon institucionet përkatëse, sipas rastit, rreth shkeljes së rregullave së etikës apo të sjelljes profesionale.

Data

Emri

Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

**Shtojca B: Marrëveshja standarde për ruajtjen e fshehtësisë**

**MARRËVESHJA PËR RUAJTJEN E FSHEHTËSISË**

Çështja [\_\_\_\_\_]

Meqë, unë, i nënshkruari

Deklaroj se jam angazhuar si këshilltar i jashtëm nga *[Emri i Palës/Palëve të cilëve u jepet akses në bazën e të dhënave nëpërmjet këshilltarëve të tyre]* ("*[Pala/Palët]*") në lidhje me **çështjen** [\_\_\_\_\_] dhe jam i autorizuar përkatësisht nga e njëjta palë të ndërmarr veprimet e mëposhtme:

Meqë, AK, për t'i dhënë mundësinë *[këshilltarit të jashtëm ekonomik/konsulentit të jashtëm ligjor]* të *[Palës/Palëve]* të verifikojë vlefshmërinë e analizës së të dhënave, ka vënë në dispozicion një bazë të dhënash me të dhëna të mbledhura nga *[Emri i palës(ëve) që kanë depozituar të dhëna]*, të cilat janë përdorur nga AK gjatë hetimit ("Të dhënat" siç specifikohet në Shtojcën 1 të Kushteve për zbulimin e sekreteve tregtare dhe informacioneve të tjera konfidenciale "Për këshilltarët e jashtëm" ("Rregullat për bazat e të dhënave"));

Meqë, për të verifikuar vlefshmërinë e analizës së AK, *[Pala më ka/Palët]* më kanë liruar nga detyrat dhe detyrimet profesionale që kam ndaj palëve që bëjnë njoftimin, si *[këshilltar i jashtëm ekonomik/konsulent i jashtëm ligjor]* në procedurën e përmendur më sipër, për t'i zbuluar të gjitha të dhënat përkatëse klientëve të mi;

Meqë, të dhënat përbëjnë sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale dhe nuk duhet t'i zbulohen në asnjë rrethanë *[Palës/Palëve]* dhe asnjë palë të tretë;

Për rrjedhojë, deklaroj :

- (i) të përdor të dhënat vetëm për përgatitjen e raportit të bazës së të dhënave ("Raporti i bazës së të dhënave") drejtuar *[Palës/Palëve]*, dhe nëse është e nevojshme, për përgatitjen e një versioni të paredaktuar dhe konfidencial të raportit të bazës së të dhënave drejtuar AK (sipas seksionit 3 të rregullave për bazat e të dhënave) me gjetjet dhe konkluzionet e mia mbi *[vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e analizave sasiore të AK, të përdorura në hetim/faktin nëse provat cilësore të dosjes së AK mbështesin kundërshtimet e ngritura prej tij]*;
- (ii) të mos kopjoj (në asnjë format, fizik, dixhital ose tjetër) ose fshij të dhëna nga baza e të dhënave, dhe të zbatoj plotësisht procedurat e përcaktuara në rregullat për bazat e të dhënave të bashkëngjitura;
- (iii) të mos zbuloj, transmetoj, komunikoj apo të vë të dhënat e siguruar nga ofruesi i të dhënave ose të përfshira në raportin e bazës së të dhënave (ose

ndonjë konstatim, koment, ndërhyrje apo konkluzion të nxjerrë nga ky informacion ose nga raporti i bazës së të dhënave), në asnjë mënyrë apo formë, në dispozicion të ndonjë personi tjetër (duke përfshirë [Palën/Palët]) me përjashtim të mënyrës së përcaktuar në paragrafin v më poshtë;

- (iv) të siguroj që raporti i bazës së të dhënave nuk përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale të siguruar nga ofruesit e të dhënave, dhe që nuk zbulon në asnjë mënyrë sekrete tregtare apo informacione të tjera konfidenciale, qoftë drejtpërdrejtë, tërthorazi apo në mënyrë indirekte;
- (v) t'i përcjell AK raportin e bazës së të dhënave, përpara se t'ia komunikoj [Palës/Palëve], në mënyrë që të verifikohet që nuk është kopjuar apo zbuluar asnjë sekret tregtar apo informacion tjetër konfidencial;
- (vi) të informoj menjëherë AK për çdo shkelje të këtyre veprimtarive, qoftë si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të mia, apo të veprimeve të të tjerëve, sapo të vihem në dijeni; dhe
- (vii) të siguroj pajtueshmërinë e plotë me kushtet e kësaj marrëveshjeje nga të gjithë personat që punojnë me mua në çfarëdo cilësie në shqyrtimin dhe analizimin e të dhënave në bazën e të dhënave dhe/ose përgatitjen e raportit të bazës së të dhënave, dhe të ofroj një listë të gjithë këtyre personave pranë AK dhe nënshkrimin e pranimi të tyre të kushteve të kësaj marrëveshjeje.

.....  
Emri:  
Funksioni:  
Data:  
Vendi: